



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:025134

Datë: 29.05.2024

Numri i dokumentit: 05752494

C.nr.3068/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Florid Hasku dhe me bashkëpunëtorin profesional Zef Qupi, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses D.M., nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Fitim Gashi, avokat në Prishtinë dhe Arben Biblekaj, avokat në Prishtinë, Rr."Fehmi Agani" Hy-25/4 – Prishtinë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 1,439.10 euro, jashtë seancës, më 29 maj 2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses D.M., nga Gjakova, dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses së lartcekur në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 26 muaj, dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 06.02.2023, t'ia paguajë shumën prej 1,439.10 euro, me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 27.12.2023 (datë e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria Komunale e Arsimit, që në emër të shpenzimeve të procedurës paditëses t'ia paguaj shumën prej 124.00 euro, në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja, përmes të autorizuarve të saj, në këtë gjykatë me datë 27.12.2023, ka parashtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditësja është i

punësuar tek e paditura në Shkollën “...” në Gjakovë. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që të detyrohet e paditura që t’ia paguaj paditëses në bazë të kualifikimit për periudhën nga data 01.01.2021 e deri me datën 06.02.2023, t’ia paguaj shumën prej 1,439.10 euro, ka kërkuar kamatën ligjore, si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria e Arsimit, përmes të autorizuarës së saj, me datën 15.02.2024, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi, ku ka theksuar se ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pabazuar me arsyetimin se paditëses nuk i takon ky kompensim sepse nuk është përcaktuar me kontratën e punës të cilën kontratë e ka nënshkruar paditësja dhe është pajtuar me kushtet, detyrat dhe obligimet që i ka. Po ashtu, paditëses nuk i takon ky kompensim as me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës e ku askund nuk e parasheh që punëtorëve të arsimit iu takon kompensimi i tillë, prandaj kërkesës se paditëses i mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësja nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënës i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Po ashtu e njëjta është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pabazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 të LPK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është në tërësi e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontratat e punës për paditësen e lëshuara nga Komuna e Gjakovës–Drejtoria e Arsimit, këtu e paditura, paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në Shkollën “..... në Gjakovë, si mësimdhënëse. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës, vërtetohet fakti se paditësja ka realizuar pagë bazë në lartësi prej 421.00 euro dhe në emër të licencës paditëses për çdo muaj për periudhën kontestuese i është paguar shuma prej 58.32 euro. E njëjta ka diplomuar me datën 18.07.2009 dhe ka marrë titullin Bachelor i programit fillor, fakt që vërtetohet nga diploma e lëshuar nga Universiteti i Prishtinës me numër 77. Po ashtu paditësja ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 100008508.

Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, vendim i cili ka qenë në fuqi deri me datë 06.02.2023, ku është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik numër 08/L-196. Sipas këtij vendimi, në pikën 1 është përcaktuar se *“Që nga data 01.09.2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*, ndërsa pika 4 nën-pika 4 e tij, ka përcaktuar se *“Me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27%”*. Pasi që nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, se e njëjta ka diplomë universitare me titull bachelor dhe po ashtu ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës, rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 06.02.2023 apo për 26 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca në shumë të përgjithshme prej 1,439.10 euro, për këtë kriter të kompensimit.

Duke qenë se kjo gjendje faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, pasi që e paditura në asnjë formë nuk e ka kontestuar faktin se paditësja është e punësuar tek e paditura dhe se të njëjtës për periudhën janar 2021 - shkurt 2023, për 26 muaj i është kompensuar shuma prej 58.32 euro për çdo muaj, mirëpo nuk i është kompensuar pjesa tjetër e shtesave në emër të kualifikimit shumë prej 55.35 euro për çdo muaj, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seancës konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Sa i përket pretendimit të të paditurës se kërkesa është e parashkruar në tërësi është i pabazuar, pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 27.12.2023, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre (3) viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 par.1 të LPK-së, me ç’rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124.00 euro. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00 euro (e paraparë sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), për përpilimin e padisë shuma prej 104.00 euro, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.3068/23, më 29 maj 2024

Gj y q t a r i

Florid Hasku

### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të aktgjykimit, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të parashtrohet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.